



**URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

Drejtuar :

Adresa :


Per dijeni: Debitorit- Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D

Adresa: Njesia 2, Rruga "Budi", Sheshi Demokracia, Tirane

Për dijeni: Kreditorit – Shoqeria "Global Logistic" shpk, me Nipt K72113028G

Adresa: Autostrada Tirane-Durres, Km. 5

**Qendres Kombetare Te Regjistrimit
TIRANE**



Pranë "Shërbimit Përmbarimor ZIG Shpk" është depozituar kërkesa për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv, "Fature Tatimore shitje Nr. 8148, date 02.03.2016 me Nr. Serie 207015945", e Kreditorit – Shoqeria "Global Logistic" shpk, me Nipt K72113028G, së bashku me Urdherin e Ekzekutimit "Vendim Nr. 4859 Akti, date 28.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane".

Pas kalimit në ekzekutim të detyrueshëm si edhe Lajmërimit për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendim Nr. 4859 Akti, date 28.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA SE :

Debitori Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi aktivet e debitorit Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile",

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative ne aktivet e pales debitore Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D, te regjistruar prane jush.
2. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me vendosjen e mases se sekuestros konservative ne pjeset/kuotat qe Shoqeria "COOP – STUDENTI" shpk me Nipt L52202041D, zoteron ne shoqeri te tjera te regjistruara prane jush.
3. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
4. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së mjeteve të luajshme në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (kater) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën ankimit te vecante sipas K.Pr.Civile, para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

**"Shërbimi Përmbarimor ZIG Shpk"
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Albert GEGA**

